


# RAPORTI TEKNIK


## ***“SISTEMIM I RRUGEVE TE BRENDSHME, FSHATI VRANISHT, BASHKIA HIMARË”***

### PROJEKT ZBATIMI



**Projektues:**

**“Engineering Consulting Group” SHPK**



Tiranë 2022



## RELACION TEKNIK

### TË PËRGJITHSHME

#### **Pozicioni gjeografik**

Vranishta është një fshat i njësise administrative Hore – Vranisht, pjesë e Bashkisë Himare, me një pozicion gjeografik në jug-perëndim të Shqipërisë.

Vranishta ka një sipërfaqe përgjithësisht të sheshtë, pjesa tjetër është sipërfaqe kullësore malore, sipërfaqe të zhveshura e përrunjësh.



Rruga për në pjesën e brendshme të fshatit Vranisht përfaqëson një trase ekzistuese të një rruge jorbane me parametra të ulët infrastrukturor dhe në gjendje të pamirëmbajtur. Me ndërtimin e kësaj rrugë do të mundsohet qarkullim më i lehtë i qytetarëve për nevojat e tyre.

Rruga shtrihet në një terren kodrinor dhe shpejtësia e projektimit është  $V=40$  km/h. Kjo rrugë i përket Kategorisë 5 sepse treguesi i volumit të qarkullimit është shumë i vogël dhe numri i përgjithshëm i automjeteve në 24 orë është  $<1000$ .

Profili terthor i rrugës është simetrik me një karrexhatë 3 metra dhe me dy bankina 0.5 m në secilën anë të rrugës. Shtresat kryesore janë Beton 10 cm dhe stabilizant 15 cm.

#### **ENGINEERING CONSULTING GROUP**

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob: +355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C  
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Bryllit", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com





Kullimi i ujrave sipërfaqësor është projektuar në njerin krah të rruges nga ana e majte duke qene se pjerresia natyrale e terrenit na mundeson nje rrjedhje te lire. Pjerresia e perdorur eshte 2% ne menyre qe të largohen ujrat e shiut.

### **Relievi**

Vranishta është e rrethuar nga një kurorë malesh të larta: mali i Bogonicës në perëndim (pjesa e vargut të Çikës) me lartësi 1672m dhe në pjesën verë – lindore nga Maja e Kendrevices. Këto male përbëhen nga shkëmbinj gëlqerorë dhe shpatet e tyre bien pjerrtas mbi luginën e Vranishtes (rrjedhjet e sipërme). Pjesët e poshtme të shpatave zbresin në formë kodrash të ulëta, të përbëra nga flishe (shtufe) e argjile. Ato janë të veshura me shkurre. Pjesë përbërëse e relievit janë edhe luginat e lumenjve dhe përrenjve, për gjatë gjithë gjatësisë së shtrirjes së fshatit.

### **Klima**

Klima e Vranishtes është midis asaj të butë mesdhetare të Borshit dhe klimës së ashpër të Kurveleshit të sipërm. Me temperature mesatare vjetore 14 °C, temperature mesatare të dimrit 5.7 °C dhe mesatare të verës 23,3 °C

Këto ndryshime në temperaturë lidhen me pozitën më në brendësi të vendit, me largësinë më të madhe nga deti dhe me relievin e mbyllur midis maleve. Kurse sasia më e madhe e reshjeve së Borshi, shpjegohet me konfiguracionin e relievit. Erërat e lagështa që vijnë nga deti, duke hyrë nëpër luginat në Vranisht, ndrydhen nga malet përreth duke lëshuar sasira të mëdha shirash. Në Vranisht bien 2670 mm shi në vit.

### **Ujërat**


Zona e Vranishtes ka pasuri të shumta ujërash. Përrenjete përshkojnë të gjithë sipërfaqen e fshatit, por edhe burime të shumta ujore janë të pranishme, duke shënuar një nga pasuritë më të mëdha të rajonit Jugor persë I perket burimeve nentokesore. Këtu organizohen herë pas here shëtitje turistike, piknikë dhe festa të ndryshme.

### **Tokat**

Tokat – e zonës së Vranishtes janë jo shumë të trasha. Mbizotërojnë tokat e holla dhe bokërrima. Por ka edhe toka bujqësore (të hirta, kafe dhe të kafenjta). Në luginat ka toka aluvionale të pasura me humus që i bënë ato pjellore. Në to rriten shumë mirë misri, perime e drurë frutorë.

### **Mbulesa bimore**


Mbulesa bimore e zonës së Vranishtes është dëmtuar shumë nga shpyllëzimet për toka bujqësore (bukë), nga prerjet për dru zjarri, djegiet e bëra nga barinjët dhe nga kullotja pa kriter e bagëtisë (dhive). Bimësia më e përhapur janë shkurret e tipit mesdhetar (makja) të përbëra nga: sqina (xina), koçimarja, përralli, mersina, shqopa, cfaka (bezga), thrumja,



### **ENGINEERING CONSULTING GROUP**

HEAD OFFICE - TIRANE; MOB: +355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C  
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No 22, "Brylli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com





sherebeli etj. Në luginat përhapje të gjerë ka dhe hilqja dhe rrapi. Në pjesët e larta rritet bredhi e pak pisha. Ka gjithashtu kullota të pasura verore).

### ***GJËNDJA E INFRASTRUKTURËS EKZISTUESE***

#### **Gjëndja e sistemit rrugor (rrugë-trotuare)**


Infrastruktura rrugore ekzistuese në këtë fshat, objekt i këtij studimi mund të përshkruhet me pak fjalë e amortizuar për shkak të viteve dhe nga mirembajtja e ulët. Rrugët ekzistuese janë të pa shtruara, të konceptuara për një periudhë ku primare ishte lëvizja e këmbësorëve dhe ku nuk mendohej se do të lëviznin automjete private me intensitetin e sotëm. Gjëndja e tyre paraqitet e amortizuar dhe kërkon nderhyrje me infrastrukturen e nevojshme.



#### **ENGINEERING CONSULTING GROUP**

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob: +355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C  
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com





## **REALIZIMI I PROJEKTIT**

### **Kualiteti**

Kualiteti i të gjitha materialeve që duhet të përdoren në këtë objekt duke filluar nga materiali i mbushjes e deri te shtresa e Betonit duhet ti plotësojë të gjitha normat dhe rregullat teknike të aplikuara në vendin tonë (të parapara sipas kontratës për ekzekutimin e punimeve).

Ekzekutuesi duhet ti ofroj investitorit në çdo kohë të gjitha raportet e ngjeshmërisë së shtresave të mbushjes me materiale dhe tampon, që të mund të vazhdohet me pozicione te tjera.

### **Pastrimi i terrenit**

Largimi i materialit ekzistues prej konstruksionit të rrugës me qëllim të përshtatjes së niveletës apo largimit të drunjëve, rrënjëve të cilat pengojnë e sipërfaqen e rrugës nuk duhet të ndikojnë negativisht në aftësinë mbajtëse të rrugës. Cilësia e punimeve duhet ti plotësojë kushtet si me material me kualitet të rezistueshëm ndaj ngarkesave nga qarkullimi i trafikut po ashtu edhe kualiteti i ndërtimit sipas rregulloreve.

### **Gërmimi i dheut**

Gërmimi i dheut të kategorisë 3-4 dhe 4-5 bëhet sipas projektit për ekzekutimin e punimeve duke i u përshtatë niveletës për rrugën e projektuar. Dheu i gërmuar largohet deri 6km larg punishtës ose perdoret për mbushje nën trase apo në bankinat 0.5 m te gjera.

Për projektimin e rrugës është shfrytëzuar rievimi gjeodezik i gjendjes egzistuese. Caktimi i aksit të rrugës është bërë në atë mënyrë që të ju përshtatemi gjendjes faktike në teren

### **Ndërtimi i shtresës stabilizuese (10 cm)**


Ky material duhet të jetë me cilësi të mira mekanike, material guror i rezistueshëm. Shtrimi i kësaj shtrese duhet të bëhet trashësi 15 cm. Pas shtrimit, rrafshimi të bëhet me grejder, ngjeshjet me cilindër i materialit dhe të arrijnë një koeficient të ngjeshmërisë përfundimtare prej 70MN/m<sup>2</sup>. Kontrolli i aftësisë mbajtëse bëhet me pllakë rrethore me diametër 300mm, në distancë 5m. Rezistenca e materialit ndaj ngjarëve duhet ti plotësojë kushtet sipas DIN 18 196.


### **Punimi i shtresës së çakëllit, t=15cm**

Në konstruksionin e rrugës së lartpërmendur në bazë të dhënave hyrëse dhe rregullores për dimensionim të rrugëve Rsto si dhe detyrës projektuese, duhet të ndërtohet material çakëlli prej gurit të thyer gëlqeror në fraksion 0/60mm, në trashësi prej 20cm me strukturë të shpërndarë sipas rregullores gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve. Ky material i sjellë në punishte duhet të ketë përzjerje të mirë në mes fraksioneve. Materiali prej çakëlli ndërtohet sipër shtresës egzistuese në konstruksionin e rrugës. Ngjeshja e shtresës së çakëllit duhet të punohet për lagështinë optimale sipas proktorit Dpr 103%. Sigurimi i kualitetit gjatë ndërtimit duhet të organizohet prej organit mbikqyrës me kontroll të pavarur. Kontrolli i ngjeshjes së shtresës prej çakëllit duhet të kryhet me matjet e modulit të ngjeshjes, sipërfaqja për kontrollim caktohet prej organit të mbikqyrjes për

### **ENGINEERING CONSULTING GROUP**

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob: +355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C  
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Brylli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com





jo më rrallë se në çdo 50m gjatësi të rrugës me pllakë rrethore 300mm sipas DIN 181 34. Raportet në mes deformimeve gjatë kontrollimit të ngjeshjes duhet të jenë Ev2/ Ev1 më i vogël se 2.2, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë  $\geq 100 \text{ MN/m}^2$ . Rezistenca e materialit ndaj ngricave duhet ti plotësoj kushtet sipas DIN 18 196.

#### **Shtresë Zhavorr, $t=20 \text{ cm}$**

Ky seksion mbulon ndërtimin e shtresave me zhavorr ose mbeturina gurore. Shtresat me zhavorr (çakëll mbeturina) 0-31.50mm ( $d=100 \text{ mm}$ ) ose zhavorr (çakëll mbeturina) 0 – 50 mm ( $d=150\text{mm}$ ), do të kene nje trashesi prej 20 cm.

#### **Beton C20/25, $t=15 \text{ cm}$**

Trashësia e shtreses se betonit eshte projektuar te jete 15 cm me klase te betonit C 20/25. Sipërmarrësi duhet të sigurojë për qëllimet e provave një se 3 kubikësh për çdo strukturë betoni, përfshirë derdhje betoni nga 1-15 m<sup>3</sup>. Për derdhje betoni me shumë se 15 m<sup>3</sup>. Sipërmarrësi duhet të sigurojë të paktën një set shtesë 3 kubikësh për çdo 30 m<sup>3</sup> shtesë. Nëse mesatarja e provës së fortësisë së kampionit për çdo porcion të punës bie poshtë minimumit të lejueshëm të fortësisë së specifikuar, Mbikëqyresi i Punimeve do të udhezojë një ndryshim në raportet ose përmbajtjen e ujit në beton, ose të dyja, në mënyrë që Punëdhënësi të mos ketë shtesë kostoje. Sipërmarrësi duhet të përcaktojë të gjitha kampionet që kanë të bëjnë me raportet e betonimit prej nga ku janë marrë.

Përgatiti:

Ing. Ermir ÇUPI

“Engineering Consulting Group” SHPK



#### **ENGINEERING CONSULTING GROUP**

HEAD OFFICE - TIRANE; Mob: +355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C  
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, "Bryli", Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com

